

HISTORIKU I SHKOLLËS

SHFMU “MIGJENI” – RUFÇI I RI

Shkolla Filllore “Migjeni” – Rufci i Ri punën e filloi me 1926 ku mësimet i kanë ndjekur nxënësit e fshatrave: Rufci i Ri, Rufci i Vjetër, Torinë, Poturovc, Ribar i Vogël dhe Ribar i Madh.

Në klasën e Parë kanë qenë të regjistruar 66 nxënës të moshave nga 6-10 vjeq, prej tyre vetëm 17 shqiptarë, asnjë femër.

Mësimi zhvillohej në gjuhën serbe. Nxënësit shqiptarë një vitë mësonin gjuhën serbe për t'u regjistruar në klasën e parë. Në atë kohë edhe mësuesi ishte serb.

Me 1941 – 1942 shkolla filloj punën për herë të parë në gjuhën shqipe. Mësues i parë ishte Hasan Tolaj nga Elbasani i Shqipërisë.

Me 1973 shkolla pavarsohet nga Shkolla Filllore "Braça Aksiq "(Vëllezrit Frashëri) e Lipjanit dhe emërtohet me emrin e shkrimtarit “Migjeni”.

Me 13 tetor 1978 lëshohet në përdorim objekti i ri shkollor.